



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

BULETINI KORRIK-DHJETOR 2012

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është agjenci e pavarur, e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas Neneve 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

ZRRE bën rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë (Energji Elektrike, Ngrohje Qendrore dhe Gaz Natyror).



Vendimet e lëshuara nga ZRRE gjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2012

Gjatë periudhës Korrik-Dhjetor 2012 ZRRE ka lëshuar Vendime si vijon:

- Vendim V_492_2012 Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërmarrjen “Drini i Bardhë” SH.A;
- Vendimi V_490_2012 Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërmarrjen “Triangle General Contractors- Inc” Branch Kosova;
- Vendimi V_489_2012 Mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërmarrjen “Matkos Group” sh.p.k;
- Vendimi V_488_2012 Shtyerjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_296_2010 i datës 11 nëntor 2010 (me kohëzgjatje dy vjeçare), edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me 11 maj 2013, të ndërmarrjes “Kelkos-Energy” SH.p.k;
- Vendimi V_487_2012 Aprovimin e kërkesës për tërheqje të Aplikacionit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga era për projektin “Wind Park-Zatriç”, me kapacitet të instaluar prej 30 MW, KK Rahovec, të ndërmarrjes “NEK UMWELTECHNIK AG” Dega në Kosovë;
- Vendimi V_486_2012 për Lëshimin e Licencës për import dhe eksport të energjisë elektrike ndërmarrjes “HEP – KS” SH.P.K;
- Vendim V_485_2012 për Aprovimin e tarifave të ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për sezonin e ngrohjes 2012/2013;
- Vendimi V_484_2012 për Aprovimin e tarifave të ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2012/2013;
- Vendimi V_466_2012 për Metofologjine për përgatitjen e Balancave të Energjisë Elektrike;
- Vendimi V_465_2012 për refuzimin e aplikacionit për ndërmarrjen UAE- LLC - Lumi Plava-Brod;
- Vendimi V_464_2012 për refuzimin e aplikacionit për ndërmarrjen UAE- LLC Lumi Brod-Restelica;
- Vendimi V_463_2012 për refuzimin e aplikacionit për ndërmarrjen DEVOLLI GROUP shpk LEPENCI - I –II;
- Vendimi V_462_2012 për refuzimin e aplikacionit për ndërmarrjen DEVOLLI GROUP shpk JUNIK - I -II –III;

- Vendimi V_461_2012 për përfundimin e autorizimit preliminar për ndërmarrjen KTW shpk – SHTIME;
- Vendimi V_460_2012 për Modifikim licence për shpërndarje të NQ_TERMOKOS;
- Vendimi V_459_2012 për Modifikim licence për shpërndarje të NQ_GJAKOVA;
- Vendimi V_458_2012 për Modifikim Licence për furnizim public të NQ_GJAKOVA ;
- Vendimi V_457_2012 për Modifikim licence për furnizim publik të NQ_TERMOKOS;
- Vendimi V_456_2012 për Modifikim licence për prodhim të NQ_TERMOKOS;
- Vendim V_455_2012 për Modifikim licence për prodhim të NQ_GJAKOVA;
- Vendimi V_454_2012 për Standardet e planifikimit dhe të sigurisë së sistemit të shpërndarjes” të NQ Termokos SH.A;
- Vendimi V_453_2012 për Vazhdim Licence për GEN-I Tirana Sh p k;
- Vendimi V_452_2012 për Modifikimi i licencës për GEN-I Tirana Sh p k;
- Vendimi V_451_2012 për Lirim in e të licencuarve nga pagesa e taksës vjetore;
- Vendimi V_437_2012 për Vazhdimin e licencës për prodhim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës – Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.)-TC Kosova A, me numër licence ZRRE/Li_05/12_A, për periudhën nga 04 tetor 2012 deri 04 tetor 2013;
- Vendimi V_436_2012 për Modifikim të Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike (me kushte) e dhënë ndërmarrjes N.P Ibër–Lepenc;
- Vendimi V_435_2012 për Modifikim të Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike e dhënë ndërmarrjes “KelKos Energy” SH.P.K;
- Vendimi V_434_2012 për Modifikim të Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmisionit (me kushte) e dhënë Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) ;
- Vendimi V_433_2012 për Modifikim të Licencës për Operatorin e Tregut të Energjisë (me kushte) e dhënë Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë (KOSTT Sh.A) ;
- Vendimi V_432_2012 për Modifikim të Licencës së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A.)–Divizioni i Furnizimit;
- Vendimi V_431_2012 për Modifikim të Licencës së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A.)–Divizioni i Shpërndarjes;

- Vendimi V_430_2012 për Modifikim të Licencës së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A.)—Divizioni i Gjenerimit TC Kosova B;
- Vendimi V_429_2012 për Modifikim të Licencës së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A.)—Divizioni i Gjenerimit TC Kosova A;
- Vendimi V 428 2012 për Aprovim të kërkesës së KOSTT-it ku obligohet KEK-u t'i paguaj KOSTT-it faturat për periudhën tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011 në vlerë prej 3,802,949€;
- Vendimi V_419_2012 për Lejimin e KOSTT SH.A. të derogimit në zbatimin e dispozitave të neneve të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
- Vendimi V_418_2012 për Aprovim të tarifave dhe ngarkesave të transmisionit, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) SH. A. nga data 1 qershor 2012;
- Vendimet 420-427; 467-482; 491-495 për ankesa të konsumatorëve (29 refuzime të ankesave të konsumatorëve).

Pjesëmarrja e ZRRE-së në konferenca, seminare, mbledhje ndërkombëtare, Korrik – Dhjetor 2012

23-26 gusht 2012 – Trajnim i organizuar nga Instituti Kosovar për Menaxhim, lidhur me Hartimin e Legjislacionit Primar dhe Sekondar në kuadër të Institucioneve Publike në Këshillin për Legjislacion në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë; Durrës, Shqipëri.

- Fokusi i këtij trajnimi ka qenë: hartimi i legjislacionit, procesi ligjvënës, hierarkia e normave, përputhja me rendin e BE-së dhe problematika, Acquis communautaire dhe elementet kryesore që mbahen parasysh; Realiteti dhe sfidat dhe të ngjashme.

28 korrik – 4 gusht 2012 – Trajnim 1 javor për çmimet e energjisë në Universitetin e Floridës; Gainesville, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

- Ky trajnim është financuar nga NARUC (National Association of Regulatory Utility Commissioners) dhe USAID, si pjesë e partneritetit në mes Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Komisionit Komercial të shtetit Illinois, SHBA.

10 shtator 2012 - Tryezë punuese e organizuar nga Grupi Punues për Konsumator në kuadër të ECRB lidhur me “Ndërrimin e Furnizuesit nga konsumatorët”; Beçiç, Mal i Zi.

- Kompania konsulentë “Bofest Consult” përgjegjëse për përpilimin e dokumentit mbi “Ndërrimin e Furnizuesit nga konsumatorët” organizoi prezantimin dhe paraqiti të dhënat e gjetura nga 27 vende të Bashkimit Evropian si dhe të dhënat e dërguara nga shtetet nënshkruese të traktatit të Komunitetit të Energjisë.

10-11 shtator 2012 – Takimi i rregullt i Grupit Punues për Konsumator në kuadër të ECRB; Beçiç, Mal i Zi.

- Fokusi i këtij takimi është përmbledhja e të gjitha aktiviteteve dhe detyrave të caktuara në Grupin Punues për konsumator në kuadër të ECRB për tremujorshin e kaluar si dhe caktimi i detyrave të reja për tre-mujorin e ardhshëm.

11-12 shtator 2012 – Forumi i Pestë Social në kuadër të Komunitetit të Energjisë, Beçiç, Mal i Zi.

- Qëllimi i këtij forumi ishte që të shqyrtohen arritjet në implementimin e Planit Social të Veprimit (PSV) për çështjet sociale në kontekst të komunitetit të energjisë.

12 shtator 2012 – Takimi i rregullt i Grupit Punues për Energji Elektrike, organi i Bordit Rregullativ të Traktatit të Komunitetit për Energji të Evropës Jug-Lindore; Vjenë, Austri.

26-27 shtator 2012 – Mbledhja e 23-të e Grupit Punues të Gazit të ECRB / TKE EJL, Vjenë, Austri.

- Mbledhja e radhës e GPG ku ndër temat kryesore ishin: i) progresi drejt finalizimit të Strategjisë regjionale të TKE me fokus të veçantë në projektet prioritare në sektorin e gazit natyror - të ashtuquajtura Projekte të interesit të Komunitetit të energjisë (“PECI”); ii) Progresi në realizimin e iniciativës “elektricitet nga gazi natyror” (“gas to power initiative”); dhe iii) shqyrtimi i aspekteve rregullative të realizimit të Unazës së gazit, me theks në finalizimin e dokumentit punues: Realizimi i Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë – nga Teoria në Praktikë.

Forum i 7-të i Gazit Natyror, organizuar nga Sekretariati i TKE EJL.

- Temat kryesore të diskutuara në forumin e gazit ishin: i) implementimi i pakos së tretë të legjislacionit; ii) ndërlidhja e rajonit përmes projekteve të gazit – progresi në zhvillimin e projekteve kryesore si: projekti për eksploatimin e burimeve të gazit Shah Deniz, Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), Gazsjellësi Nabuko, dhe Gazsjellësi Jon-Adriatik (IAP); ii) Siguria e furnizimit me fokus implementimin e Rregullores së UE 994/2010 për sigurinë e furnizimit me gaz.

17-18 Tetor 2012 – Takimi i rregullt i Grupit Punues për Rregullim Ligjor të Asociacionit Regjional të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA); Izmir, Turqi.

06 nëntor 2012 – Takimi i Grupit Punues të ECRB EWG; Vienë, Austri.

07 nëntor 2012 – Pjesëmarrje në Workshopin “Electricity Imbalance Settlement”; Vienë, Austri.

07 nëntor 2012 – Takimi i rregullt i Grupit Punues për Konsumator në kuadër të ECRB, Vjenë, Austri.

- Fokusi i këtij takimi është përmbledhja e të gjitha aktiviteteve dhe detyrave të caktuara në Grupin Punues për konsumator në kuadër të ECRB për tremujorshin e kaluar si dhe caktimi i detyrave të reja për tremujorshin e ardhshëm.

08 nëntor 2012 – Tryezë punuese lidhur me “Cilësinë e Furnizimit me Gaz”; Vjenë, Austri.

- Fokusi i kësaj tryeze punuese ka qenë baza ligjore lidhur me cilësinë e furnizimit me gaz për shtetet anëtare nënkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe roli i rregullatorëve rreth monitorimit dhe rregullimit të kësaj fushe. Po ashtu kjo tryezë ka paraqitur edhe përvojat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian lidhur me cilësinë e furnizimit me gaz.

08 nëntor 2012 – Mbledhja e 24-të e Grupit Punues të Gazit të ECRB / TKE EJL; Vjenë, Austri.

- Mbledhja e rregullt e GPG ku fokus i takimit ishte në përfshirjen e GPG të gazit në punën për hartimin e Studimit të fizibilitetit për iniciativën regjionale “elektricitet nga gasi” të paraparë të filloj në vitin 2013. Gjithashtu u shqyrtua drafti i Studimit për sigurinë e furnizimit në TKE. Vëmendje e konsiderueshme në takim ju kushtua aktiviteteve të planifikuara për Programin e punës për vitin 2013.

Punëtorja: Kualiteti i shërbimeve të gazit natyror, organizuar nga Grupi Punues i gazit dhe Sekretariati i TKE EJL.

Prezantim i çështjeve legjislative për rregullimin e kualitetit të furnizimit me gaz, përvojës së shteteve të BE-së, dhe gjendja aktuale në rajonin e EJL sa i përket kualitetit të furnizimit.

23 nëntor 2012 - Tryeza punuese lidhur me “Implementimin e ligjit të Konkurrencës në sektorin e Energjisë”, e organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; Vjenë, Austri

- Fokusi i kësaj tryeze punuese ka qenë implementimi i ligjit të konkurrencën në sektorin e energjisë në shtete anëtare të bashkimit evropian si dhe krijimi i rrejtës së konkurrencës nga komuniteti i energjisë. Po ashtu kjo tryezë ka paraqitur edhe përvojat e shteteve anëtare të bashkimit evropian në zbatimin e ligjit për konkurrencën në sektorin e energjisë.

25-26 nëntor 2012 – Takim për Vlerësim të Aplikacionit për Autorizim për Ndërtim të Kapaciteteve të Reja Gjeneruese; Durrës, Shqipëri.

- Aplikacionit për Autorizim për ndërtimin e hidrocentralit me kapacitet 3.2 MW (HC Kuqishtë – Gryka e Rugovës), në Lumin Lumbardhë, KK Pejë, të Ndërmarrjes “N.T.SH. RIMED”, dhe

- Aplikacionit për Autorizim për ndërtimin e hidrocentraleve me njësitë “HC Kovaçic”, HC”Kamenicë” dhe “HC Doganaj” me kapacitet total prej 9.85 MW, të gjitha në lumin Lepenc, KK Kaçanik, të ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k.

03-04 dhjetor 2012 – Takim pune në Rregullatorin e Turqisë (EMRA); Ankara, Turqi.

- Fokusi kryesor i këtij takimi në mes përfaqësuesve të EMRA-së dhe përfaqësuesve të ZRRE-së është njohja nga afër e aktiviteteve të ndërmarra nga EMRA rreth monitorimit të aktiviteteve rregulluese ndaj të licencuarve.

06-09 dhjetor 2012 – Pjesëmarrje në punëtorinë për fushën e energjisë organizuar nga Ministria e integriteteve; Durrës, Shqipëri.

17-18 dhjetor 2012 – Takim pune në Entin Rregullator të Shqipërisë (ERE); Tiranë, Shqipëri.

- Fokusi kryesor i këtij takimi në mes përfaqësuesve të ERE-së dhe përfaqësuesve të ZRRE-së është njohja nga afër e aktiviteteve të ndërmarra nga ERE rreth monitorimit të aktiviteteve rregulluese ndaj të licencuarve.

Pjesëmarrja e ZRRE-së në takime, punëtori dhe seminare vendore gjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2012

03.07.2012 – Takimi në ZRRE me komisionin e konkurrencës. Temë e takimit ishte harmonizimi i objektivave, përgjegjësitë dhe bashkpunimi me ndërmjet dy institucioneve;

03.07.2012 - Takimi në ZRRE me përfaqësues të Komisionit Kosovar të Konkurrencës;

03.07.2012 - Takim me përfaqësuesit e KOSTT-it lidhur me Formularët Raportues SHTE7;

03-04.07.2012 – Takimi në KOSTT me përfaqësues të KOSTT-it (Skenderi etj). Temë e takimit ishte përpilimi i skemes aktuale të Tregut në Kosovë sipas kërkesës së EnCs;

04 dhe 07.07.2012 – Takimi në ZRRE lidhur me licecën e DSO-së;

06.07.2012 - Shpërndarja e Parimeve për llogaritjen e ngarkesave DUOS dhe TUOS te KEK dhe KOSTT për komente;

09.07.2012 - Shpërndarja e Formularëve Raportues për SHTE7 KEK dhe KOSTT-Sh. A;

18.07.2012 - Raporti Konsultativ i përcaktimit të ngarkesës për shpërndarje dhe transmision- Përgjigjet ndaj komenteve;

18.07.2012 - Aprovimi “Parimet e përcaktimit të ngarkesave në transmisionit” dhe “Parimet e përcaktimit të ngarkesave në shpërndarje”;

18.07.2012 - Aprovimi i tarifave dhe ngarkesave të transmissioinit, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) SH. A. nga data 1 qershor 2012;

19.07.2012 - Takim në MZHE me përfaqësuesit KEDS PIU&MZHE;

01.08.2012 - Takim në ZRRE me përfaqësues të kshilltarëve të privatizimit dhe përfaqësues të MZHE. U diskutuan çështje si Humbjet, Plani zhvillimor, Transferi i licencës, Garancioni për energji etj;

02.08.2012 –Takimi në Deloitte për rishikimin e dokumenteve finale të privatizimit;

03.08.2012 - Takim me KOSTT-in – Shqyrtimi Formularëve Raportues;

13-23.08.2012 dhe **7, 11, 12-13.09.2012** – Pjesëmarrje në takimin MZHE si përfaqësues i ZRRE në Grupi punues për hartimin e Strategjisë së energjisë – e rishikuar për periudhën 2013 - 2022;

16.08.2012 - Takim informues me këshilltarët e transaksionit-IFC, përfaqësues nga MZHE/NjIP KKDFEE dhe këshilltarët e pavarur te USAID /Deloitte;

23.08.2012 – Takim në MZHE për Strategjinë e Energjisë 2013-2022;

30.08.2012 – Takim në ZRRE për harmonizimin e komenteve të dokumentit të KOSTT – SOS Report;

03.09.2012 - Seancë publike - Shqyrtimit i shtatë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE 7) ;

03.09.2012 – Dëgjimi publik në lidhje me SHTE 7- shqyrtimi i 7 tarifar, hotel Sirius;

03.09.2012 – Takim në ZRRE lidhur me komentet e dokumentit të KOSTT – SOS Report;

04.09.2012 - Shqyrtimit i të të dhënave të dorëzuara në kuadër të SHTE7;

05.09.2012 – Takim në ZRRE me përfaqësues të Çalik-Limak;

05.09.2012 - Takim me Divizionit të Gjenerimit (dhe, në mënyrë implicite, atë të Minierave), Aplikacioni për të hyrat e kërkuara;

05.09.2012 - Takim ZRR-KEK _KOSTT, Bilanci energjisë elektrike;

06.09.2012 - Takim ZRRE-OSSH&AQ sqarime për aplikacionin e SHTE7;

07.09.2012 – Takim në konsulentët e projektit asistencës për ZRRE në lidhje me të dhënat e balancës që kanë lidhje me tarifat;

10.09.2012 - Takim, ZRRE-FPEE sqarime për aplikacionin e SHTE7;

11.09.2012 - Takim,ZRRE-KOSTT sqarime për aplikacionin e SHTE7;

11-12.09.2012 – Takim në MZHE për Strategjinë e Energjisë 2013-2022;

12.09.2012 – Takim me përfaqësuesit e NQ Gjakova; diskutim për çështjet e raportimit rregullativ, dhe për përmbajtjen e projekt propozimit për WBIF;

13.09.2012 - Takim në ZRRE me përfaqësuesit e KFOR-it (HQ) lidhur me kontestin në mes KFOR dhe KEK;

13 & 17.09.2012 – Takim në ZRRE për Dizajnin e Tregut;

17.10.2012 – Takim me përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar -FMN së bashku me MZHE – KEK lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e tarifave , si dhe privatizimin e KEDS-it;

19.10.2012 - Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KOSTT-it;

19.10.2012 - Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut;

20.09.2012 – Takim në ZRRE për Licencat dhe Standardet e Sigurisë;

20.09.2012 – Takim në ZRRE për dhënien e autorizimit për ndërtim për kompaninë Triangle për ndërtimin e HC në Junik në lumin Erenik;

25.09.2012 – Takim në MZHE për Metodologjia për punimin e balanceve të Energjisë;

27.09.2012 – takim në mes të përfaqësuesit te NQ Termoks (Ilir Azemi); për sqarime shitesë lidhur me komentet e ZRRE në raportimin rregullativ;

02.10.2012 – Takim i serishëm në ZRRE për dhënien e autorizimit për ndërtim për kompaninë Triangle për ndërtimin e HC në Junik në lumin Erenik;

03.10.2012 – Takim në ZRRE për përgjigjen e ZRRE për Gjykatë lidhur me vendimin për kontestin KOSTT-KEK;

03.10.2012 – Takim me përfaqësuesit / konsultantët e KfW dhe të NQ Termokos për ecurinë e implementimit te Projektit te ko-gjenerimit;

10.10.2012 - Takim në ZRRE me Komitetin drejtues për asistencën e EU për ZRRE-në;

12.10.2012 - Takim i Bordit të ZRRE dhe aprovimi i dokumentit të punuar nga KOSTT Metodologjia për punimin e balanceve të Energjisë;

24.10.2012 - Takim në ZRRE për Web faqen dhe asistencën për ZRRE;

13 & 15.11.2012 - Takim në ZRRE për trajnimet në Turqi, Shqipëri, Mal të Zi dhe Hungari;

15.10.2012 – Takim në KOSTT me përfaqësuesit e KOSTT-it lidhur me kontestin në mes KOSTT dhe KEK;

15.11.2012 - Takim mes ZRRE dhe Termokos; informim për përgatitjet për fillimin e sezonin 2012-2013, dhe për aktivitetet e ndërmarra për furnizim të mjaftueshëm gjatë sezonit të ngrohjes;

21.11.2012 – Pjesmarrje në KOSTT në Workshopin për Rregullat e Tregut;

Të gjithë Rregullat dhe Vendimet e ZRRE-së janë në dispozicion në: www.ero-ks.org

21.11.2012 – Takim me përfaqësuesit e NQ Gjakova; informim për aktivitetet përgatitore për sigurimin e furnizimit të mjaftueshëm me ngrohje gjatë sezonit të ngrohjes;

21.11.2012 - Tryezë punuese lidhur me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë;

23.11.2012 - Takim në ZRRE me përfaqësues të MZHE dhe KOSTT për komentet e Sekretariatit të Energjisë;

26.11.2012 - Takim ZRRE-OSSH&FPPEE sqarime për aplikacionin e SHTE7;

27.11.2012 - Takim ZRRE-Gjenerim&Miniera sqarime për aplikacionin e SHTE7;

27.11.2012 – Pjesmarrje në workshopin në AEAI: Advisory Services to privatization of KEK Distribution and Supply;

27.11.2012 - Tryezë punuese lidhur me “Roli dhe rëndësia e monitorimit të të licencuarve”, e organizuar nga Advanced Engineering Associates International (USAID) në Prishtinë;

Fokusi kryesor i kësaj tryeze ka qenë roli dhe rëndësia e monitorimit të ndërmarrjeve rregulluese, duke filluar nga identifikimi i ndonjë modeli sa më të përshtatshëm për monitorimin e aktiviteteve rregulluese ndaj të të licencuarve;

07.12.2012 –Takim me përfaqësuesen e KfW - Bahrije Dibra lidhur me projektin e ko-gjenerimit – aspektet rregullative për realizimin e projektit dhe draft marrëveshja për furnizim me energji termike;

14.12.2012 – Takim i përbashkët në mes të Departamentit të tarifave dhe Bordit për prezantim të modelit tarifore shumë vjeçar (ETR7) (Suharekë) ;

19.12.2012– takim në mes të ZRRE dhe Termokos; diskutim për tarifën e aprovuar dhe për çështjen e faturimit të NQ Termokos nga Ujësjetësi i Prishtinës për shpenzimin e ujit në sistemin sekondarë të ndërtesave;

20.12.2012 – Takim në ZRRE për dhënien e autorizimit preliminar për ndërtim për kompaninë Triangle për ndërtimin e HC në Junik në lumin Erenik;

20.12.2012– Takim në MZHE si përfaqësuese e ZRRE në Grupin punues për hartimin e Planit të 2të Nacional të Veprimit për Efiqencën e Energjisë;

24.12.2012- Takimi në Departamentin për përkujdesjen e konsumatorëve në KEK;

Ky ishte një takim jo formal i përcaktuar më herët e që kishte për qëllim diskutimin si dhe dhënien e ndihmës KEK-ut dhe Komunës së Podujevës në lidhje me mosdhënien e pëlqimit elektroenergetik për kycjen e lokaleve (tregut të ri) të ndërtuar nga Komuna e Podujevës në rrjetin elektrikë;

27.12.2012 – Takim mes ZRRUK dhe ZRRE; baza rregullative dhe mundësitë për zgjidhjen e çështjes kontestuese të faturimit të NQ Termokos nga Ujësjellësi i Prishtinës për shpenzimin e ujit në sistemin sekondarë të ndërtesave;

27.12.2012 – Takim në KOSTT për Balancën elektroenergjetike 2013;

28.12.2012 - Takim i Bordit të ZRRE dhe aprovimi i i derogimeve të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Kodi i Rrjetit dhe Licenca e OST për KOSTT. Si dhe shqyrtimi i kërkesës për aprovim të Planit Zhvillimor të Transmisionit 2013-2022, për të cilin u vendos të bëhet kërkesë për informacione shtesë për disa nga projektet dhe disa shpenzime të paraqitura në Planin Investiv.

Aktivitetet e ZRRE-së për periudhën Korrik – Dhjetor 2012

Aktivitetet kryesore të Departamentin të Tarifave dhe Çmimeve gjatë periudhës korrik – dhjetor 2012 janë:

- Shqyrtimi shumë-vjeçar i tarifave të energjisë elektrike (SHTE7);
- Shqyrtimi i bilancit energjetik, importit, MPKK-së, investimeve kapitale dhe operative dhe parametrave parametrave të tjerë rregullator.

Në qershor 2012 ZRRE, kishte inicuar Shqyrtimin e Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE7) i cili do të mundësojë përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për një periudhë shumë-vjeçare(2013-2017). Këto të Hyra Maksimale të Lejuara duhen të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kostot e kapitalit që kanë të bëjnë me aktivitet e rregulluara. Për të përcaktuar shumën e të Hyrave të nevojshme, ZRRE është duke vlerësuar parashikimet e të licencuarve për kostot e nevojshme dhe të arsyeshme dhe të arsyeshme. Baza ligjore i obligon të licencuarit të ofrojnë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ZRRE për qëllim të vlerësimit të kësaj analize.

Aktivitetet kryesore të Departamentit Ligjor dhe i Licencimit (DLL) gjatë kësaj periudhe ka harmonizuar licencat në përputhje me ndryshimet e legjisllacionit primar dhe sekondar në sektorin e energjisë. Licencat e harmonizuara janë paraqitur për konsultim publik dhe disa komente të palëve të interesit janë përfshirë në to.

Po ashtu për aktivitetin e licencimit, gjatë kësaj periudhe DLL ka përcjellë dhe ka paraqitur para Bordit të ZRRE-së për licencim aktivitetin e Import dhe Eksportit të Energjisë Elektrike nga ndërmarrja: “HEP – KS SH.P.K”. Ndërmarrjeve që kanë aplikuar për vazhdim licence si: “Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A – Divizioni i Gjenerimit – TC Kosova A” – aktiviteti i gjenerimit të energjisë elektrike dhe “GEN-I TIRANA Sh.P.K DEGA NË KOSOVE” - aktiviteti i Import dhe Eksportit të Energjisë Elektrike, Bordi i ZRRE-së u ka vazhduar licencat, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe raportuese DLL ka pranuar këto aplikacione për Autorizim për ndërtim të kapaciteteve gjeneruese nga uji si: N.T.SH.RIMED me kapacitet 3,2MW në Lumin Peja, MHC Kuqishtë, Gryka e Rugovës; Triangle General Contractors-INC-Branch Kosova me kapacitet 3,6MW, Lumi Lepenc HCV, Shtërpçë, 5.2MW Lumi Lepenc HCV Lepenc & Shtërpçë, dhe 2.2MW Lumi Lumbardhi i Prizrenit, HCV Reçan. Po ashtu ka pranuar një aplikacion për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues nga era nga ndërmarrja Upwind International I GmbH, Dega në Kosovë me kapacitet prej 30 MW. Të gjitha këto aplikacione janë në shqyrtim e sipër.

Për këto ndërmarrje “Triangle Gneral Contractors – INC Branch Kosova” (me kapacitet 11.7 MW), “Drini i Bardhë Sh.A” (me kapacitet 9.9 MW) dhe “Matkos Group SH.P.K” (me kapacitet 9.85 MW) të cilat kanë aplikuar për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues nga uji, Bordi i ZRRE-së ka lëshuar Autorizimin Preliminar.

Aktivitetet kryesore të Departamentit të Tregut të Energjisë gjatë kësaj periudhe raportuese është angazhuar në monitorimin e ndërmarrjeve energjetike përmes analizimit përpunimit dhe sistematizimit të të dhënave ditore dhe mujore që pranojnë nga të licencuarit në bazë të rregulltë nga ku janë nxjerrur raporte mujore dhe kuartale të funksionimit të sistemit elektroenergjetik.

Po ashtu janë analizuar dokumente të ZRRE-së dhe të licencuarve, si dhe ato të arritura nga institucionet vendore apo ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe DTE është angazhuar në plotësimin e pyetësorëve të arritur nga institucionet vendore apo ndërkombëtare.

Aktivitetet kryesore të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve gjatë periudhës raportuese Korrik – Dhjetor 2012 Departamenti ka qenë i angazhuar në mbrojtjen e konsumatorëve duke bërë shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve si dhe të kontesteve në mes të licencuarve. Po ashtu ka qenë e angazhuar në biseda direkte me palët duke i njoftuar ata me të drejtat e tyre që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë.

Gjatë kësaj periudhe DMK ka bërë shqyrtimin e kontestit mes KOSTT dhe KEK lidhur me refuzimin e pagesës për shërbimet e transmisionit dhe kthimin e faturave për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011. Përveç shqyrtimit të kontestit mes KOSTT dhe KEK, DMK ka qenë e angazhuar edhe në përgatitjen edhe të përgjigjeve në padi për Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me padinë e bërë nga KEK-u për ZRRE-në ndaj vendimit të Bordit të ZRRE-së për kontestin mes KOSTT dhe KEK.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë analizuar procedura dhe dokumente të ZRRE-së dhe të licencuarve, si dhe të ato ndërkombëtare.

DMK ka qenë e angazhuar edhe në plotësimin e pyetësorëve të arritura nga institucionet vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Gjatë periudhës së ardhshme DMK do të vazhdoj të merret me mbrojtjen e Konsumatorëve duke përfshirë shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve si dhe kontesteve në mes të licencuarve. Në kuadër të kësaj do të angazhohet edhe me pranimin e palëve duke pasur biseda direkte lidhur me njoftimin me të drejtat e tyre për sektorin e energjisë.

Gjatë kësaj periudhe DMK do të angazhohet në monitorimin e ndërmarrjeve energjetike në fushën e mbrojtjen së konsumatorëve.

Aktivitetet kryesore të Departamentit për Ngrohje Qendrore dhe Gaz ndërlidhen së pari me shqyrtimin dhe analizën e raporteve rregullative me informatat dhe të dhënat të realizuara nga ndërmarrjet e NQ në sezonin 2011/2012, me qëllim të krahasimit dhe bashkërendimit me të dhënat përkatëse të planifikuara.

Shqyrtimi i çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin 2012/2013 – hartimi dhe finalizimi i dokumenteve përkatëse për ndërmarrjet e NQ: Përcaktimi i të Ardhurave të lejuara për sezonin 2012-2013 dhe Përcaktimi i tarifave për sezonin 2012/2013.

Pjesëmarrje në hartimin e drafteve përfundimtare të licencave të modifikuara të ngrohjes qendrore.

Monitorimi i rregullt i Ndërmarrjeve të NQ – mbledhja e të dhënave dhe informatave si dhe analizimi i tyre, me qëllim të vlerësimeve përkatëse për zbatimin e kornizës rregullative dhe përmbushjes së kushteve të licencave.

Analizimi përfundimtarë dhe hartimi i draftit final për paraqitje para Bordit të ZRRE i dokumentit: Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes – NQ Termokos.

Përcjellja e implementimit të Projektit të ko-gjenerimit për furnizim me energji termike TC Kosova B – NQ Termokos; në këtë kuadër bashkëpunimi dhe koordinimi me KfW dhe NQ Termokos, si dhe analizimi dhe komentimi i dokumenteve përkatëse.

Përcjellja e zhvillimeve rajonale lidhur me çështjet e gazit natyror, veçanërisht në kuadër të Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore (KEEJL) – pjesëmarrja në punën e Grupit Punues të Gazit të ECRB (ECRB GPG), Forumin e Gazit dhe në aktivitetet tjera relevante organizuar nga Sekretariati i KEEJL.

Analizimi, komentimi dhe përgatitja e dokumenteve të ndërlidhura me gazin natyror dhe punën e GPG, si pyetësorët, raportet e dokumente tjera relevante

Aktivitetet e planifikuara të ZRRE-së për periudhën Janar – Qershor 2013

Në periudhën e ardhshme ZRRE planifikon aktivitete si në vijim:

- Shqyrtimi i Aplikacionit të për Transfer Licence nga Korporata Energjetike e Kosovës SH.A në Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji.
- Vlerësimi i aplikacioneve për Licencim të aktiviteteve në sektorin e energjisë.
- Vlerësimi i aplikacioneve për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.
- Analizimi, komentimi dhe vlerësimi i dokumenteve përkatëse të dorëzuara në ZRRE për aprovim nga të licencuarit.
- Takimet e rregullta të Grupit Punues për energji elektrike pranë ECRB.
- Takimet eventuale të Grupit Punues për Zyrën e ankandëve të koordinuara.
- Takimet e rregullta të Grupit Punues për Qeverisjen e Kodeve Teknike Operacionale.
- Takimet rreth Rregullave të Tregut.
- Takime rreth dokumenteve tjera relevante.
- Shqyrtimi dhe zgjidhja e ankesave të konsumatorëve si dhe kontesteve në mes të licencuarve;
- Monitorimi i përmbushjes së kushteve dhe kërkesave që rrjedhin nga licencat e kompanive të ngrohjes qendrore;
- Kompletimi i kornizës rregullative për ngrohjen qendrore; veçanërisht finalizimin e Rregullit për Përcaktimin e Çmimeve të Ngrohjes Qendrore, dhe Metodologjisë Tarifore, si dhe finalizimi i modelit tarifar dhe dokumenteve tjera përkatëse;
- Shqyrtimi, komentimi dhe hartimi i drafteve përfundimtare për aprovim nga Bordi i ZRRE, i dokumenteve:
- Kodi i shpërndarjes (NQ Termokos)
- Procedura për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve (NQ Termokos)
- Standardet e Planifikimit dhe të sigurisë së Sistemit të shpërndarjes (NQ Gjakova).
- Vazhdimi i pjesëmarrjes në Grupin punues për hartimin e Planit të 2të Nacional të Veprimit për Efiqencën e Energjisë.

- Vazhdimi i përcjelljes e implementimit te Projektit të ko-gjenerimit për furnizim me energji termike TC Kosova B – NQ Termokos; në këtë kuadër bashkëpunimi dhe koordinimi me KfW dhe NQ Termokos, si dhe analizimi dhe komentimi i dokumenteve përkatëse.
- Pjesëmarrje në mekanizmat e TKE EJK për çështjet lidhur me gazin natyror – Grupi punues i gazit i ECRB, Forumi gazit dhe aktivitete tjera përkatëse;
- Analizimi, komentimi dhe përgatitja e dokumenteve të ndërlidhura me gazin natyror dhe punën e GPG të ECRB - TKE, si pyetësorët, raportet dhe dokumentet tjera relevante;
- Kompletimin e kornizës rregullative për ngrohjen qendrore; veçanërisht finalizimin e Rregullit për Përcaktimin e Çmimeve të Ngrohjes Qendrore, dhe Metodologjisë Tarifore, si dhe finalizimi i modelit tarifor dhe dokumenteve tjera përkatëse.